



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës

01.Nr. 670/04-2155/25
Kaçanik, 23.01.2025

Në mbështetje të nenet 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr. 400/01-21277/24 si dhe nenet 14, 15 të Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM
Për Ndarjen e Bursave dhe Caktimin Kriterëve për Vitin Akademik 2024-2025

1. Me këtë Vendim caktohen kushtet për aplikim, kriteret e përzgjedhjes, kohëzgjatja e realizimit të bursave, lartësia dhe numri i përfrituesve të bursave.
2. Për vitin akademik 2024-2025, Komuna e Kaçanikut ndan 50 bursa për student të studimeve themelore universitare, në shumën 50 € në muaj (për 10 muaj).
3. Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kriterë:
 - 3.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
 - 3.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës,
 - 3.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
 - 3.4 të jenë student të vitit të dytë e me lartë,
 - 3.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
 - 3.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Makineri dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor).
4. Nga një familje mund të përftoj vetëm një student, ndërsa përfritues do të jetë ai student që ka notën mesatare më të lartë.

5. Studentët të cilët i plotësojnë kriteret nga pika 3 e këtij vendimi, gjatë aplikimit duhet t'i paraqesin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Rregulloren Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Për zgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtyre kriterëve:

6.1 Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10,

6.2 Studentët e drejtimeve deficitare nga pika 3.6 përfitojnë 5 pikë,

6.3. Studentët të cilët i takojnë kategorive të dala nga lufta (fëmijët e dëshmoreve, invalidëve, veteranëve dhe martirëve të luftës), u shtohen 2 pikë,

6.4 Studentët me gjendje të rëndë ekonomike dhe studentë me aftësi të kufizuara, u shtohen 2 pikë dhe

6.5 Dy e më shumë studentë nga një familje, u shtohen 1 pikë.

7. Ky vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

8 . Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset: Drejtoria e Arsimit.

9. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Arkiva.

